



Njoftim për Shtyp

ANNOTAZIONI VIDEO

Silvia Giambrone prezanton *“Pratiche performative e rituali domestici”*.

E mërkurë 12 mars 2025, ora 18:30

Instituti Italian i Kulturës në Tiranë paraqet takimin e dhjetë të ciklit **Annotazioni Video**, kushtuar **Silvia Giambrone**-n, e cila do të prezantojë një përzgjedhje prej katër video/performanca, të realizuara në pesëmbëdhjetë vitet e fundit. Aktiviteti i titulluar *“pratiche performative e rituali domestici”* për të theksuar metodologjinë dhe temat e zhvilluara nga artistja përgjatë kërkimit të saj, organizohet në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë dhe **Qendrën e Artit Agimi** dhe do të zhvillohet ditën e mërkurë, 12 mars 2025, në orën 18:30, pranë Qendrës së Artit Agimi.

Shfaqja e videove do të ndiqet nga një bisedë me Silvia Giambrone, të drejtuar nga kuratori i ciklit Annotazioni Video, **Stefano Romano**.

Kur artistët filluan ta përdorin trupin e tyre si hapësirë për të krijuar art, e zhvendosën vëmendjen e spektatorit nga një objekt – një pikturë, skulpturë, instalacion, e kështu me radhë – tek një subjekt, duke e shndërruar në këtë mënyrë trupin e tyre në një hapësirë-prag mes një mendimi dhe një objekti “estetik”.

Asnjë objekt artistik nuk është neutral në vetvete; kur përdoret brenda një vepre arti, shndërrohet në metaforë dhe bëhet politik (në kuptimin që përfshin sferën sociale të një individi), por trupi shton nivele të mëtejshme kompleksiteti. Edhe pse gjatë performancës bëhet “tjetër”, kthehet në koncept, në mjet shprehës, ai mbetet sërish një subjekt. Është mish, gjak, emocione dhe qasja jonë si spektatorë ndryshon në mënyrë të pashmangshme, sepse hyn në lojë empatia me interpretuesin/en.

Çfarë del në pah në performancat e Silvias janë çështjet dhe dinamikat me të cilat jemi mësuar aq shumë, saqë as që i shohim dhe as që e kuptojmë se janë rregulla shoqërore, të ndërtuara për të caktuar role dhe se diktohen kryesisht nga burrat ndaj grave.

“Annotazioni Video” është një projekt kushtuar video-artit, i artikuluar në një sërë takimesh me disa prej protagonistëve të artit bashkëkohor italian e shqiptar, që kanë si fill bashkues videon. Kurator i projektit: Stefano Romano.

Ashtu si çdo mjet tjetër shprehës, edhe videoja ka qasje dhe nuanca të ndryshme gjuhësore, që e bëjnë atë një medium kompleks, ndonëse mjaft intuitiv, veçanërisht në këtë moment historik, ku ideja e imazhit në lëvizje është kthyer në pjesë përbërëse të fluksit të vazhdueshëm të përvojës sonë me ndërfaqen teknologjike. Koncepti i shënimeve lidhet me mbajtjen shënim, kapjen e një elementi mbi të cilin duam të reflektojmë apo të ruajmë në kujtesë. Ai ka të bëjë me çfarë na bën më fort përshtypje në fluksin e informacionit mes të cilit gjendemi, pra flet për ne, përcakton vendin tonë lidhur me atë që kemi përballë. Ai mundëson një kohë përpunimi të asaj çfarë shikojmë dhe ashtu si praktika e mbajtjes shënim, përmban një ndalesë kohore, një thellim, një zgjedhje që na jep mundësinë të lexojmë realitetin, nga një këndvështrim që përndryshe nuk do ta kishim rrokur.

“Duke prezantuar në Tiranë, një përzgjedhje të prodhimit video artistik italian më të fundit, si dhe duke ftuar artistë italianë të takojnë komunitetin artistik dhe krijues shqiptar, Instituti synon të rinovojë dhe përforcojë

lidhjet tradicionalisht të forta midis komuniteteve artistike të dy Vendeve, duke inkurajuar dialogun. dhe shkëmbimin mes dy brigjeve të Adriatikut”, thotë drejtori i Institutit Italian të Kulturës në Tiranë, Alessandro Ruggera.

Formati i këtij projekti është konceptuar me shfaqjen e videos apo filmit, të ndjekur nga një bisedë me artistin dhe kuratorin.

Silvia Giambrone, Agrigento (1981); jeton dhe punon mes Romës dhe Londrës. Lëvron fushën e performancës, instalacionit, skulpturës, videos dhe tingullit. Hulumtimi i saj fokusohet tek format e fshehura të nënshtrimit. Gjatë katër viteve të fundit është vlerësuar me çmime të shumta dhe ka marrë pjesë në konferenca dhe rezidenca të ndryshme në Europë dhe Shtetet e Bashkuara. Ka qenë ambasadore për Kaunas, qyteti evropian i kulturës për vitin 2022. Është fituese e çmimit VAF 2019. Veprat e saj janë blerë nga disa muze dhe fondacione ndërkombëtare.

Disa nga ekspozitat e saj më të rëndësishme përfshijnë: W Women in Italian Design, Triennale Design Museum, Milano (2016); Corpo a corpo, La Galleria Nazionale, Romë (2017); Terra mediterranea: in action, NiMAC, Nicosia, Qipro (2017); Wall- eyes. Looking at Italy and Africa, Keynes Art Mile, Johannesburg (2019); VII Premio Fondazione VAF, Stadtgalerie Kiel, Gjermani (2019); Sovvertimenti, Museo Novecento, Firenze (2019); Nobody’s room. Anzi, parla, Museo del Novecento, Milano (2020); I say I, La Galleria Nazionale, Romë (2021); Hall of Shadows, Dior show FW2021, Pallati i Versajës, Francë (2021); Mascarilla 19 – Codes of domestic violence, LOOP Festival, Fundació Antoni Tàpies, Barcelonë, Spanjë (2021); Mascarilla 19 – Codes of domestic violence, Castello di Rivoli, Rivoli, Itali (2021); Reclaiming and Making: Art, Desire, Violence, Museum Of Sex, New York, NY(2022); INTERTWINGLED – The role of the Rugs in Art, Craft and Design, La Galleria Nazionale, Romë (2022); Fine Arts Festival 2022, Los Angeles (2022); Female Feedback Film Festival, Los Angeles / Toronto (2022); Mill of performing Art, Larisë, Greqi (2022); San Francisco Arthouse Festival, CA (2022); Accolade Global Film Festival, Los Angeles (2022); Edisplay International Film Festival, Paris (2022); London Indie Short Film Festival (2022); World of Film International Festival, Glasgow (2022); Florida shorts (2022); Some things, Fondazione Nicola Del Roscio, Romë (2022); Turning Pain into Power, Kunst Mean (2022); Sensei Tokyo filmfest (2023); Tokyo Film award (2023); Reise nach Italien, Goethe house, Romë (2023) ; You owe me one, Prometeo Gallery, Milano (2023); Cinequest Film & VR Festival, San Jose, Kaliforni (2023); Sexually explicit content, PAC Padiglione Arte Contemporanea, Milano (2023); Reise nach Italien, Berlin IIC(2024); Giorni felici?, Fondazione Merz, Palermo (2024); Oedipe. L’abime de l’ame, IIC Paris (2024); Japan International Film Festival (2024); Tokyo International Short Film Festival (2024); Munich New Wave Short Film Festival (2024); Made in cloister, Napoli (2024); Rencontres internationales, Berlin (2024); Futuro Festival, Romë (2024); Toronto indie filmmakers festival (2024); Madrid International short film festival (2024); Seoul International short film festival (2024); San Francisco International New Concept Film Festival (2024); La Passione, Fotogalleriet, Oslo (2024); Intelligenze emotive, Galleria Civica, Trento (2025).

ANNOTAZIONI

VIDEO

Paraqitje videosh artistike

Një projekt i ideuar, prodhuar dhe organizuar nga Instituti Italian i Kulturës në Tiranë.

Drejtor: Alessandro Ruggera.

Kurator: Stefano Romano.

12 mars 2025

Ora 18:30

Qendra e Artit Agimi

Gjuha e aktivitetit: italisht